REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës:	2020:133358
Datë:	01.07.2021
Numri i dokumentit:	01944675

ARJ nr. 68/2021

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Albert Zogaj dhe Shukri Sylejmani dhe anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen juridike të paditësit, Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës,(SHSKUK) në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës,(MPMS-IP), me seli në P., me bazë juridike anulim i vendimit të organit të paditur nr./2020, të dt.05.10.2020, dhe propozim për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruar nga pala me interes juridik B. S, për mesë përfaqësuesit sipas autorizimit avokat Avdi Dinaj nga ....., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA. Nr. 348/2021, të datës 26.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 29.06. 2021, merr këtë:

A K T GJ Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e palës me interes juridik B. S., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA. Nr. 348/2021, të datës 26.04.2021.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr.348/2021, të dt.26.04.2021, janë refuzuar si e pabazuara ankesat e të paditurës, Inspektoratit të Punës, dhe palës me interes juridik B. S., ndërsa është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A nr.1690/2020, i datës 16.03.2021.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, AA.nr.348/2021, të dt.26.04.2021, pala me interes juridik për mes përfaqësuesit sipas autorizimit avokat Avdi Dinaj, në afat ligjor në Gjykatë Supreme ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën konteston ligjshmërinë e aktvendimit të goditur për shkak të; shkeljes së dispozitave të procedurës dhe për shkak shkeljes së të drejtës materiale. Propozon që kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktvendimet e kontestuara, i Gjykatës së Apelit, AA nr. 348/2021, i dt. 26.04.2021, dhe i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A nr. 1690/2020, i dt. 16.03.2021, të ndryshohen në atë mënyrë që mos të shtyhet ekzekutimi i

2021:130421

Vendimit MPMS-IP, nr..... i dt. 05.10.2020, apo aktvendimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA mbajti seancën, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesë, ekzaminoi aktvendimin e kontestuar të shkallë së dytë dhe atë të shkallës së parë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshme të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, janë refuzuar si të pabazuara ankesat e të padituës, Inspektoratit të Punës dhe palës me interes juridik B. S., ndërsa është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A nr.1690/2020, i datës 16.03.2021, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesa e paditësit Bordi Drejtues i SHSKUK dhe është shtyrë ekzekutimi i vendimit të padituës i Inspektoratit të Punës, nr. ...., i datës 05.10.2020, deri sa gjykata të vendos me vendim përfundimtar përkitazi me padinë e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë aktvendimin e saj e kishte nxjerrë duke vendosur në ri procedurë në këtë çështje dhe duke vepruar sipas vërejtje dhe sugjerimeve sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme me nr. ARJ-UZVP nr. 5/2021, të dt. 28.01.2021, me të cilin ishte aprovuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e të padituit IP dhe palës interesuar B. S. dhe ishin anuluar aktvendimet i Gjykatës së Apelit nr. 628/2020 i dt. 18.11.2020 dhe i Gjykatës së shkallës së parë A nr. 1690/2020 i dt. 14.10.2020, dhe lënda ishte kthyer në rivendosje me të cilët ishte aprovuar propozimi i palës paditëse Bordi drejtues i SHSKUK, për shtyrjen e ekzekutimit të aktvendimit të palës së paditur- Inspektoratit të Punës.

Me nenin 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative parashihet se, me kërkesën e paditësit akti i organit i cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Ndërsa me dispozitën e nenit 22 paragraf 6 të njëjtit ligj ,përcaktohet se paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni.

Kolegji i kësaj gjykate duke e shqyrtuar kërkesën e palës me interes juridik, vendimin e atakuar të gjykatës së apelit dhe atë të shkallës së parë, duke u bazuar në dispozitën e cituar si më lartë ligjore gjen se, gjykata e shkallës së dytë ka vendosur drejtë bazuar në nenin 22 të LKA-së, duke e refuzuar ankesën e të padituës Inspektorati i Punës dhe palës me interes juridik B. S. dhe duke e vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, me të cilin është aprovuar kërkesa e paditësit Bordi drejtues i SHSKUK, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur deri në vendosjen meritore të çështjes me vendim gjyqësor.

2021:130421

Duke pasur parasysh që në çështjen juridike konkrete në mënyrë kumulative janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore si parashihen në nenin 22 të LKA-së, të cilat janë të domosdoshme që gjykata të nxjerrë vendim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ, nga kjo edhe kjo gjykatë vlerëson se gjykatat më të ulëta, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme kanë vendosur me aprovimin si të bazuar të kërkesës së paditësit për caktimin e masës së përkohshme, shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit, gjer në vendosjen meritore të çështjes me vendim të plotfuqishëm gjyqësor sipas padisë së paditësit. Gjykatat e instancave më të ulëta drejtë kanë vlerësuar pretendimet në kërkesë dhe plotësim kërkesë të paditësit të dt. 12.03.2021, që kanë të bëjnë lidhur me arsyet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës kur vlerësojnë se, shtyrja e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur është në dobi të funksionimit të rregullt të Bordit të SHSKUK, tani në kohë pandemie dhe përbën interes të përgjithshëm dhe me prioritet në raport me interesat individuale, andaj gjykatat vlerësojnë se është në interes publik shtyrja, sepse me ekzekutimin e tij palës paditëse do ti shkaktohej dëm i pa riparueshëm, gjer sa shtyrja nuk do ti sillte dëm të madh apo të pa riparueshëm palës së paditur apo kundërshtare përkatësisht personit të interesuar, dhe për më tepër kjo shtyrje i shmangë pasojat juridike në fund të procesit gjyqësor. Gjykatat e instancave më të ulëta po ashtu vlerësojnë se me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur nuk cenohen të drejtat e palës së interesuar sepse sido që të vendoset çështja kryesore në mënyrë përfundimtare, pala e interesuar do të gëzonte të drejtën e kompensimit për diferencën e pagesës si mjekë specialist, pozitë të cilën e ushtron tani brenda këtij institucioni, dhe pozitës që ai e kishte si Drejtor i Përgjithshëm të SHSKUK.

Nga theksimet si më lartë Gjykata Supreme vlerëson se, gjykata e shkallës së dytë dhe ajo shkallës së parë kanë dhënë arsye të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar me aprovimin e kërkesës së paditësit për caktimin e masës së përkohshme –shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, e po ashtu drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës administrative, ato të Ligjit për Konflikte Administrative dhe drejtë ka vërtetuar faktet që kanë qenë me ndikim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur.

Pretendimet në kërkesë të palës me interes juridik të cekura si më lartë, si dhe theksimet e tjera në arsyetim të saj, se palës ndërhyrëse i shkaktohet dëm i pa riparueshëm sepse, sipas vendimeve të inspektoratit të punës në mënyrë të detajuar janë dhënë arsye se pse nuk janë të qëndrueshme pretendimet si në vendimin e Bordit të SHSKUK, të cilat janë trillime dhe shpifje ndaj palës ndërhyrëse, i cili për këtë ka ushtruar padi civile ndaj anëtarëve të bordit, tutje në ankesë i thekson faktet lidhur me vendosjen meritore të çështjes duke e kontestuar vendimin e organit të paditur sipas përmbajtjes së tij, si vendim të kundërligjshëm dhe jo të qëndrueshëm me të cilin palës së interesuar i ndërpritet kontrata e punës në kundërshtim me Ligjin e Punës Ligjin për shëndetësinë dhe Statutin e SHSKUK, në fund thekson se nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të inspektoratit punës ashtu si parashihet në nenin 22, të LKA-së të cilin e citon, prandaj ngelet pranë propozimit të theksuar si më lartë në kërkesë. Kolegji këto pretendime dhe të tjerat si në kërkesë i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, bindëse dhe të mjaftueshme për tu aprovuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, prandaj nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje apo vërtetimin e një gjendje tjetër nga ajo e vërtetuar nga gjykatat e instancave më të ulëta. Aktvendimet e instancave më të ulëta janë të qartë dhe të arsyetuara mjaftueshëm lidhur

2021:130421

me faktet vendimtare ashtu si parashihet në nenin 22 të LKA-së, të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë. Pjesa tjetër e theksimeve në kërkesë që kanë të bëjnë me ligjshmërinë e vendimit të organit të paditur në këtë fazë të procedurës, vendosjes për masë të përkohshme, nga gjykata nuk shqyrtohen sepse do të prejudikohej vendosja meritore e çështjes kryesore sipas padisë.

Gjykata Supreme vlerëson se në këtë çështje edhe e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë dhe nuk është cenuar ligji në dëm të palës me interes juridik apo palës së paditur. Kolegji gjithashtu potencon se, shtyrja e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, në asnjë mënyrë nuk mund të prejudikoj dhe nuk është me ndikim për mënyrën e vendosjes së çështjes kryesore sipas padisë, sepse në këtë fazë kemi të bëjmë me masë të përkohshme të aprovuar nga gjykata, e cila është e vlefshme vetëm deri në vendosjen meritore të çështjes.

Nga sa u parashtrua si më lartë dhe në bazë të nenit 54, par.1, lidhur me nenin 22, par.2 dhe 6 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
ARJ nr. 68/2021, me datë 29.06.2021

Procesmbajtës,
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani

2021:130421